



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

VENDIM

Nr. 47, datë 08.02.2022

**PËR
MIRATIMIN E “RAPORTIT VJETOR MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONIT TË
PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT
PËR VITIN 2021”**


Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 16, të nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit për vitin 2021” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



**RAPORTI VJETOR MBI VEPRIMTARINË
E
KOMISIONIT TË PLANIFIKIMIT STRATEGJIK,
ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT
PËR VITIN 2021**

PËRMBAJTJA

1.	<u>HYRJE</u>	<u>4</u>
2.	<u>KOMPETENCAT E KOMISIONIT TË PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE PLANIFIKIMIT STRATEGJIK</u>	<u>4</u>
3.	<u>VEPRIMTARIA E KOMISIONIT NË SHIFRA</u>	<u>5</u>
4.	<u>ARRITJET E KOMISIONIT GJATË VITIT 2021</u>	<u>6</u>
5.	<u>AKTIVITETI I KOMISIONIT SIPAS FUSHAVE TË VEPRIMTARISË</u>	<u>7</u>
6.	<u>PËRMIRËSIMET NË INFRASTRUKTURËN TEKNOLOGJIKE NË FUNKSION TË RRIJES SË TRANSPARENCËS, EFICENCËS DHE AKSESIT NË SISTEMIN GJYQËSOR</u>	<u>21</u>
7.	<u>PLANIFIKIMI FINANCIAR NË FUNKSIONIM TË ADMINISTRIMIT TË MIRË DHE EFIKAS TË VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT DHE GJYKATAVE.....</u>	<u>25</u>
8.	<u>VENDIMMARRJE TË KPSAB DHE PROJEKTE.....</u>	<u>30</u>
9.	<u>REKOMANDIME</u>	<u>31</u>

1. HYRJE

Veprimtaria e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (KPSAB), si një strukturë e përhershme e Këshillit të Lartë Gjyqësor i nënshtrohet detyrimit ligjor përcaktuar në pikën 16, të nenit 62 të Ligjit Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, sipas të cilit parashikohet që: *“Brenda muajit janar të çdo viti kalendarik, secili komision i përhershëm paraqet në mbledhjen plenare të Këshillit raportin vjetor të veprimtarisë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.”*

KPSAB është një ndër 4 strukturat e përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor, i cili u konstitua gjatë mbledhjes plenare të datës 18.01.2019. Komisioni ushtron funksione të qenësishme lidhur me planifikimin strategjik, administrimin dhe buxhetin e vetë Këshillit si dhe sistemit gjyqësor në tërësi, duke ndihmuar kështu Këshillin e Lartë Gjyqësor në përmbushjen me efikasitet dhe cilësi të përgjegjësisë dhe detyrimeve ligjore.

Përpos të qenit një detyrim ligjor, hartimi i këtij raporti vjetor është një proces vetë-vlerësimi dhe vetë-reflektimi mbi sfidat dhe arritjet përgjatë vitit 2021. Vlen të theksohet se, viti 2021 nuk ishte një vit i cili do të mundësonte funksionimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së Komisionit në kushte optimale. Kjo për vetë faktin se veprimtaria e këtij komisioni vazhdoi në kushtet e pandemisë globale të shkaktuar nga Covid-19 sikurse edhe mes vështirësive që mbarti procesi i rivlerësimit kalimtar lidhur me vakancat e krijuara në sistemin gjyqësor (veçanërisht për pjesën e nëpunësve civil gjyqësor). Rrjedhimisht, Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit i duhej jo vetëm të përshtatej, por njëkohësisht dhe të garantonte aftësinë e tij reaguese në kohë e me vizion për problematikat me të cilat përballej sistemi gjyqësor.

Nërkaq, sjellim në vëmendje se në përputhje me detyrimin e parashikuar nga pikat 2 e 12 të nenit 62 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në mbledhjen plenare të KLGJ-së të datës 23.12.2021 u krye dhe ndryshimi i përbërjes së Komisioneve të përhershme të Këshillit, nga ku dhe përbërja e Komisionin e Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit u ndryshua. Në përbërje të këtij Komisioni marrin pjesë:

- Znj. Naureda Llagami, Kryetare
- Znj. Marçela Shehu, anëtare
- Znj. Fatmira Luli, anëtare
- Znj. Brikena Ukperaj, anëtare zëvendësuese
- Z. Erjon Muharremaj, anëtar zëvendësues

2. KOMPETENCAT E KOMISIONIT TË PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Kompetencat e komisionit burojnë nga Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Kuadri ligjor i ka atribuar KPSAB-së funksione të rëndësishme në tre nivele: *strategjik, administrativo-menaxherial, si dhe lidhur me politikën buxhetore dhe financiare.*

Sa i përket funksionit **strategjik**, me qëllim ndjekjen e dinamikave të sistemit dhe marrjen e masave specifike për t'iu përgjigjur në kohë dhe me efikasitet nevojave të tij, komisioni harton dhe monitoron zbatimin e Planit Strategjik të vetë Këshillit, i cili funksionon si barometër i brendshëm për vlerësimin e veprimitarisë së Këshillit në drejtim të vetë-rregullimit dhe mirëqeverisjes së sistemit gjyqësor. Ndërkaq, kjo kompetencë lidhet edhe me ndërmarrjen e masave të tjera strategjike, qoftë edhe në nivele *ad hoc*, për adresimin e çështjeve specifike me të cilat ballafaqohet Këshilli dhe sistemi gjyqësor.

Nga ana tjetër, kompetencat **administrativo – menaxheriale** lidhen me rregullimin e brendshëm të gjykatave nga pikëpamja e burimeve njerëzore, infrastrukurore dhe pasurive të paluajtshme/aseteve, si dhe përcaktimin e standardeve etike profesionale të nëpunësve civil gjyqësor, me qëllim garantimin e një sistemi funksional dhe eficient. Mirë-administrimi i sistemit gjyqësor ka një fokus të veçantë në veprimtarinë e Komisionit, pasi garanton jo vetëm mbarëvajtjen e sistemit, por njëkohësisht përcakton standardet dhe premiset për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të sistemit për t'iu përgjigjur në kohë dinamikave të ndryshme.

Ndër të tjera, KPSAB është përgjegjës edhe për hartimin, miratimin dhe monitorimin e **politikave buxhetore dhe financiare** për Këshillin dhe sistemin gjyqësor, duke garantuar burimet e nevojshme financiare në kuadër të mbarëvajtjes së funksionalitetit të vetë Këshillit dhe gjykatave në vend. Kjo kompetencë e Komisionit evidentohet veçanërisht gjatë procesit të planifikimit të projekt-buxhetit afatmesëm (PBA), negocimit dhe monitorimit të zbatimit të këtij buxheti, me qëllim jo vetëm garantimin e standardeve të menaxhimit financiar, por edhe vlerësimin të situatës financiare dhe buxhetore të Këshillit dhe sistemit gjyqësor. Sipas nevojave të identifikuar, Këshilli bën shpërndarjen e fondeve për përmbushjen e tyre.

Në ushtrimin e kompetencave të veta, sikurse vihet re nga sa më sipër, ky Komision gëzon një kontribut thelbësor në kuadër të përmbushjes së misionit madhor që Këshilli ka, lidhur me qeverisjen, mbarëvajtjen dhe mirë-administrimin e sistemit gjyqësor.


3. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT NË SHIFRA

KPSAB, si struktura përgjegjëse për hartimin, miratimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik, politikave administrative, financiare dhe buxhetore në funksionin të menaxhimit të mirë e efikas të sistemit gjyqësor në vend, gjatë vitit 2021 ka realizuar 34 mbledhje, në të cilat janë marrë **106** vendime, 92 prej të cilave në fushat përkatëse të veprimitarisë si më poshtë vijon:

- **16** në fushën e planifikimit strategjik
- **64** në fushën e administrimit dhe efikasitetit
- **12** në fushën e planifikimit dhe menaxhimit financiar dhe buxhetor

14 vendimmarrje të Komisionit i referohen miratimit të procesverbaleve të mbledhjeve plenare, në përputhje me detyrimin ligjor që ka Këshilli përkundrejt transparencës në marrëdhëniet me publikun. Përmes faqes së internetit të Këshillit, ky detyrim është përmbushur brenda afateve ligjore të arsyeshme duke kontribuar në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së

punës së KLGJ-së përkundrejt qytetarëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar mbi veprimtarinë e tij.



4. ARRITJET E KOMISIONIT GJATË VITIT 2021

Në veprimtarinë e tij gjatë vitit që lamë pas, Komisioni ka vijuar punën e tij, i udhëhequr nga parimet e profesionalizmit, integritetit, dhe paanshmërisë, duke shënuar disa arritje. Me gjithë vështirësitë e shumta si për shkak të pandemisë së Covid-19, ashtu edhe për shkak të vakancave të krijuara në sistemin gjyqësor nga procesi i rivlerësimit kalimtar, vendimmarrjet e Komisionit si në numër ashtu edhe në cilësi dëshmojnë angazhim për të reaguar në kohën e duhur dhe me mjetet e nevojshme ndaj problematikave të evidentuara në sistemin gjyqësor në vend.

Duke qenë se një pjesë e madhe e vendimmarrjeve, rreth 70% të tyre, janë të rëndësishme në kuadrin e ndërtimit të një administrate civile gjyqësore profesionale, Komisioni ka bashkëpunuar ngushtë me Komisionet e Përhershme të Këshillit, aktiviteti i të cilave është i ndërvarur dhe me veprimtarinë dhe funksionet e komisioneve të tjerë. Ky bashkëpunim vjen në funksion të bashkërendimit të angazhimeve për garantimin e ekselencës së sistemit gjyqësor në të gjitha nivelet.

Disa prej arritjeve më të spikatura të Komisionit¹ janë:

Të rëndësishme!

- ❖ **92 akte të hartuara dhe miratuara.**
- ❖ **Miratimi i rregulloreve për shqyrtimin e praktikave korruptive në Këshillin e Lartë Gjyqësor, hetimin administrativ të sinjalizimit, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe ruajtjen e konfidencialitetit.**
- ❖ **Rritja e efikasitetit të Gjykatës së Lartë nëpërmjet shtimit të stafit administrativ dhe mbështetjes teknike në sistemin e menaxhimit të çështjeve.**

¹ Komisioni vlerëson se, meqenëse veprimtaria e tij është e ndërvarur me veprimtarinë e tre Komisioneve të tjera të përhershme të Këshillit, rekomandimet e tij do të parashtrohen në Raportin Vjetor të Këshillit.

- ❖ Zbatimi i reformës për nëpunësin civil gjyqësor² përmes përfundimit të verifikimit të kriterëve dhe kualifikimi për emërim në shërbimin civil gjyqësor i 10 punonjësve në funksion të garantimit të një administrate sa më profesionale dhe me integritet të lartë në ushtrimin e detyrës, konkretisht i 7 këshilltarëve ligjorë pranë njësisë ligjore të Gjykatës së Lartë dhe 10 ndihmës ligjorë në gjykatat e apeleve.
- ❖ Përfundimi i verifikimit të kriterëve ligjore, pasurisë dhe integritetit për 2/3 e kancelarëve në detyrë³ me qëllim garantimin e profesionalizimit, integritetit dhe pastërtisë së figurës për këta funksionar publik.
- ❖ Realizimi i buxhetit për sistemin gjyqësor (KLGJ dhe gjykatat) në masën 91%*, duke reaguar në mënyrë të shpejt dhe të drejtë ndaj nevojave të sistemit gjyqësor, në funksion të menaxhimit të fondeve buxhetore me efikasitet dhe efektivitet.
- ❖ Vazhdimi i përmirësimeve në sistemin aktual të menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS (nëpërmjet 37 zhvillimeve të reja si dhe trajtimi i 667 kërkesave për mbështetje teknike nga të gjithë gjykatat) pas solli rritjen e transparencës, efikasitetit dhe aksesit të qytetarëve në vendimmarrjet e gjykatave.
- ❖ Përgatitja e vendimmarrjeve me qëllim krijimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit dhe miratimi i “Projekt - Udhërrëfyesit për sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve.”

* Kjo përfaqëson raportohet nga realizimi i pritshëm i buxhetit dhe do të përditësohet pas përfundimit të raportit (12muajor) me degën e thesarit Tiranë për KLGJ-në dhe me degët e thesarit në rrethe për gjykatat.

5. AKTIVITETI I KOMISIONIT SIPAS FUSHAVE TË VEPRIMTARISË

Bazuar në hulumtimet dhe punën kërkimore, Komisioni ka propozuar, hartuar dhe paraqitur për miratim në Këshill akte, rregullore apo udhëzime të ndryshme të cilat kanë pasur në fokus adresimin e problematikave në nivelin strategjik, administrativ dhe financiar të vetë Këshillit si dhe sistemit gjyqësor në Shqipëri.

Vendimmarrjet e KPSAB të realizuara gjatë vitit 2021 në funksion të Planifikimit Strategjik janë si më poshtë vijon:

- 🚩 **Vendimi nr.34, datë 28.01.2021 “Për caktimin e një anëtari të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”.** Ky vendim gjen mbështetje të Vendimi nr. 972, datë 02.12.2020 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin dhe përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”, i cili parashikon krijimin e Bordit Drejtues të QTISD-së, në përbërje të të cilit, krahas përfaqësuesve nga institucionet e tjera, është edhe një anëtar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në këto kushte KPSAB i propozoi Këshillit të Lartë Gjyqësor caktimin e një anëtari në Bordin Drejtues të kësaj Qendre. Anëtari i zgjedhur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kryen njëkohësisht edhe funksionin e Kryetarit të Bordit Drejtues të QTISD-së, bord i cili është organ kolegjal vendimmarrës dhe garanton mbështetjen e duhur administrative dhe organizative për funksionimin e kësaj qendre të rëndësishme të sistemit gjyqësor.

2E cila merr zanafillën nga miratimi i vendimit “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata” i vitit 2020.

3 Ka përfunduar verifikimi nga KPSAB-së për 25 kancelarë nga 34 në detyrë.

- ✚ Vendimi nr.39, datë 04.02.2021 “Për miratimin e “Raportit Vjetor mbi Veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit për vitin 2020”.** Veprimtaria e KPSAB-së, si një ndër katër komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i nënshtrohet detyrimit ligjor të përcaktuar në pikën 16, të nenit 62 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Miratimi i këtij raporti, krahas përmbushjes së detyrimit të lartpërmendur ligjor, i shërben rritjes së transparencës së publikut dhe njëkohësisht monitorimit të efijencës së funksionimit të KPSAB-së përgjatë vitit 2021.
- ✚ Vendimi nr.176, datë 29.04.2021 Për miratimin e “Raportit Vjetor të Sistemit Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020”.** Miratimi i Raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor është një detyrim që buron nga neni 82 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i cili përcakton se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor raporton para Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, jo më pak se një herë në vit”. Ky raport vjetor përveç pasqyrimit të veprimtarisë së kryer nga KLGJ përgjatë vitit 2020 ofroi një përshkrim shterues, në analizë dhe në detaje, të situatës dhe funksionimit të sistemit gjyqësor, bazuar në të dhënat e raportuara nga vetë gjykatat.
- ✚ Vendimi nr.258, datë 17.06.2021 “Për caktimin e tre anëtarëve në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë” i ndryshuar me vendimin nr.418, datë 29.09.2021⁴.** Ky vendim gjen mbështetje te Vendimi nr. 972, datë 02.12.2020 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”, i cili parashikoi krijimin e Bordit Drejtues të QTISD-së, në përbërje të të cilit janë edhe tre përdorues fundor, të përzgjedhur nga gjykatat e shkallëve të ndryshme dhe nga gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në përfundim të shqyrtimit të kandidaturave të propozuara, Komisioni vendos ti propozojë Këshillit caktimin e tre kandidatëve që plotësonin kriteret për të qenë anëtarë të Bordit Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.
- ✚ Vendimi nr.277, datë 01.07.2021 “Për miratimin e formularit në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.** Hartimi dhe miratimi i formularit tip ishte një detyrim ligjor i Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përmbushje të nenit 10 “Paraqitja dhe shqyrtimi i shprehjes së interesit”, pika 3, shkronja e), të ligjit nr. 115/2016, të ndryshuar. Ky akt vjen në kuadër të garantimit të pavarësisë, përgjegjshmërisë, efijencës dhe transparencës së procesit të përzgjedhjes të anëtarëve të rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Formulari tip është strukturuar në disa seksione të cilat në bazë të informacionit që kërkohet, synon të hedh më shumë dritë mbi pastërtinë e figurës dhe integritetit të kandidatit për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁴ Vendimi nr.418, datë 29.09.2021 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.258, datë 17.06.2021 “Për caktimin e tre anëtarëve në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”. Kolegji i Posaçëm i Apelit njoftoi shpalljen e vendimit “shkarkim nga detyra” të një gjyqtari i cili ndërkohë me vendimin e KLGJ-së nr.258, datë 17.06.2021 ishte caktuar anëtar në Bordin Drejtues të QTISD-së. Me mbarimin e statusit të magjistratit ky gjyqtar nuk mund të ushtronte funksionin e anëtarit të Bordit Drejtues të QTISD-së, funksione të cilat lidheshin drejtpërdrejtë me statusin e tij të magjistratit. Për këtë arsye Këshillit ju propozua, nga KPSAB, zëvendësimi i këtij anëtar me një tjetër magjistrat.

- ✚ **Vendimi Nr.361, datë 14.09.2021, “Për caktimin e një anëtarit në Komisionin për Mbrojtjen e Gjyqtarëve ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”.** Në kushtet kur mandati i anëtarit dhe njëkohësisht kryetarit të Komisionit për mbrojtjen e gjyqtarëve përfundonte më 26.09.2021 ishte e nevojshme vendimmarrja e Këshillit për caktimin e një prej anëtarëve të tij në Komisionin për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, anëtar i cili njëkohësisht do të jetë edhe kryetari i këtij Komisioni. Vendimi ka caktuar një prej anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor si anëtar i Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, i cili njëkohësisht do të ushtrojë edhe detyrën e kryetarit të tij.
- ✚ **Vendimi nr.530, datë 10.11.2021 “Për miratimin e listës së gjyqtarëve kandidat për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2022”**, në kuadër të së cilës KPSAB është angazhuar me verifikimin e kriterëve që duhet të plotësojnë kandidatët për t’u përzgjedhur si anëtarë të KED. Pas verifikimeve të bëra KPSAB-ja i ka propozuar Këshillit listën e gjyqtarëve, kandidatë, që plotësojnë kushtet për t’u zgjedhur si anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Në funksion të rolit strategjik të KPSAB-së dhe lidhur me rritjen e transparencës, forcimin e integritetit, parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sistemin gjyqësor dhe mirë-funksionimin e KLGJ-së, përmendim vendimet si më poshtë vijon:

- ✚ **Vendimi nr.441, datë 05.10.2021 “Për miratimin e rregullores “Për shqyrtimin e praktikave korruptive në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.** Kjo rregullore gjen mbështetje në ligjin nr. 9508, datë 03.04.2006 “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit” i cili ka për qëllim të nxisë pjesëmarrjen e publikut në denoncimin e korrupsionit, duke mbrojtur e nxitur personat, të cilët denoncojnë praktikën abuzive dhe korrupsionin në autoritetet publike. Në hartimin rregullores u morën parasysh pikërisht këto kërkesa të ligjit. Rregullorja ka për qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Përgjegjës, si dhe zhvillimit të procedurës që lidhet me shqyrtimin e praktikave korruptive në KLGJ.
- ✚ **Vendimi nr.442, datë 05.10.2021 “Për miratimin e rregullores “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.** Kjo rregullore gjen mbështetje në ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar. Ky ligj ka për qëllim parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sektorin publik e privat, mbrojtjen e individëve që sinjalizojnë veprimet apo praktikën e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës si dhe nxitjen e sinjalizimit të veprimeve apo praktikave të dyshuara korruptive. Në frymën e ligjit, rregullorja ka për qëllim të përcaktojë rregullat e brendshme të posaçme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit të këtij procesi në KLGJ.
- ✚ **Vendimi nr.443, datë 05.10.2021 “Për miratimin e rregullores “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit dhe mbrojtjen nga hakmarrja në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.** Kjo rregullore plotëson kuadrin nënligjor të nevojshëm për zbatimin praktik të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, dhe ka për qëllim përcaktimin e rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në institucionin e KLGJ-së.

Në kushtet kur gjatë vitit 2021 u krye ripërtëritja e pjeshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ky i fundit miratoi dhe vendimarrjet për ndryshimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të tij⁵ të propozuara nga KPSAB-ja apo Kryetarja e KLGJ-së për këtë proces, si vijon:

- ✚ **Vendimi nr.601 datë 23.12.2021 “Për përbërjen e Komisioneve të Përhershme të Këshillit”.** Ky vendim përcakton përbërjen e re të Komisionit të Planifikimit Strategjik Administrimit dhe Buxhetit (KPSAB), Komisionit Disiplinor (KD), Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (KVEVP), si dhe të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës (KZHK).
- ✚ **Vendimi nr.602 datë 23.12.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr. 15, datë 22.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.** Sipas këtij Vendimi, përcaktohet përbërja e re e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të subjekteve të tjera të rivlerësimit.

Ndër vendimarrjet e KPSAB në funksion të mirë-administrimit dhe rritjes së efijencës së sistemit gjyqësor, përmendim:

- ✚ **Udhëzimi nr.85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur”.** Propozimi i këtij projekt udhëzimi erdhi si pasojë e paqartësive që u konstatuan gjatë zbatimit në praktikë të Vendimit nr. 622 datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për të adresuar problematikat e hasura nga gjykatat në procesin e rekrutimit në shërbimin civil gjyqësor, KPSAB-ja, vlerësoi të nevojshme rregullimin e mëtejshëm të këtij procesi përmes Udhëzimit të propozuar. Krahas dispozitave të përgjithshme të cilat rregullojnë procesin e rekrutimit dhe fazat nëpërmjet të cilave realizohet ky proces, një vëmendje e veçantë në këtë Udhëzim i është kushtuar rregullave të detajuara edhe shembujve konkret për mënyrën e zhvillimit të intervistës dhe vlerësimeve të kandidatëve për secilën fazë. Kjo vendimarrje e Komisionit përkon me procesin transformues që Këshilli ka ndërmarr në funksion të rritjes së efijencës së sistemit gjyqësor, duke sfiduar konceptin e deritanishëm të administratës gjyqësore si dytësore në funksionimin e shërbimeve të drejtësisë.
- ✚ **Vendimi nr.99, datë 18.03.2021 “Për caktimin e vendit të zhvillimit të seancave gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”.** Meqenëse salla e vetme e gjykimit, funksionale në dispozicion të Kolegjit Zgjedhor, nuk mund të shërbente me korrektësi për parandalimin e përhapjes së virusit SARS-CoV-2 si dhe duke mbajtur në konsideratë rolin e rëndësishëm dhe interesin e lartë publik të aktivitetit të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, KPSAB i propozoi Këshillit caktimin e një salle, e cila do të mundësonte plotësimin tërësisht të kushteve të nevojshme për zhvillimin e seancave gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor.

⁵Vendimi nr.581 datë 13.12.2021 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Medi Bici”; Vendimi nr.582 datë 13.12.2021 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Ilir Toska”; Vendimi nr.583 datë 13.12.2021 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Brunilda Kadi”.







Vendimi Nr.574, datë 07.12.2021, “Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit mbi zbatimin e projektit pilot “Përdorimi i postës elektronike për dërgimin e fletëthirrjeve nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë tek avokatët”. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në Kodin e procedurës civile, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ka vendosur miratimin e përmbajtjes së Memorandumit të Mirëkuptimit që u lidh ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë, duke i hapur rrugë fillimit të zbatimit të projektit pilot “Përdorimi i postës elektronike për dërgimin e fletëthirrjeve nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë tek avokatët”. Ky vendim synon rritjen e shpejtësisë dhe saktësisë së kryerjes së njoftimeve nga Gjykatat kundrejt avokatëve, si dhe shkurtimin e kohës në këtë drejtim, me qëllim shtimin e efikasitetit të gjyqësorit dhe përshpejtimin e proceseve në tërësi.

Me qëllim pasjen e trupës gjyqësore por dhe personelit gjyqësor ndihmës dhe mbështetës, KPSAB-ja⁶, në zbatim të dispozitave ligjore ka zhvilluar procedurën për verifikimin e kancelarëve në detyrë. Procedura e nisur gjatë vitit 2020 është në fazat e fundit. Kështu gjatë vitit 2021 ka përfunduar verifikimi për 25 kancelarë nga të cilët 20 janë përfunduar me vendime të KLGJ-së ndërsa 5 prej tyre janë në pritje për t’u shqyrtuar në seancë plenare nga Këshilli.

Me anë të vendimeve në seancë plenare, KLGJ-ja, me propozim të Komisionit ka vendosur kualifikimin për 16 kancelarë në detyrë në gjykata e shkallës së parë dhe apelit për juridiksionin e përgjithshëm, ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për 2 kancelarë dhe përfundimin e shqyrtimit pa vendimmarrje për shkak të dorëheqjes për 2 kancelarë.

Vendimmarrje që kanë lidhje me konfirmimin, ngritjen në detyrë, ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, apo kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelarëve të gjykatave, të tilla si vijon:

-  **Vendimi nr. 10, datë 14.01.2021, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar”.** Përmes këtij vendimi është miratuar fillimi i procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve formale, të pasurisë dhe figurës, për kancelarët në detyrë. Gjithashtu, ky vendim ka caktuar edhe relatorin për secilin kancelar në detyrë.
-  **Vendimi Nr.307, datë 13.07.2021, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së znj. Taviola Myftari në pozicionin e kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”.**
-  **Vendimi Nr.399, datë 22.09.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional, të kancelarit në detyrë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, z. Aleksandër Dino”.**
-  **Vendimi Nr.400, datë 22.09.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional, të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, znj. Geralda Kasuli”.**

⁶ Këtu përfshihen dhe anëtarët zëvendësues të Komisionit, Znj. Brikena Ukperaj dhe z. Erjon Muharremaj të cilët gjithashtu janë angazhuar në këtë proces.

- ✚ **Vendimi Nr.405, datë 29.09.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional, të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, znj. Oriana Dervishi”.**
- ✚ **Vendimi Nr.406, datë 29.09.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional, të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, z. Argjend Qesja”.**
- ✚ **Vendimi Nr.434, datë 04.10.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional, të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, znj. Frida Gani”.**
- ✚ **Vendimi Nr.435, datë 04.10.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional, të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, znj. Marsida Jani”.**
- ✚ **Vendimi Nr.453, datë 07.10.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional, të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, znj. Ardiana Krasniqi”.**
- ✚ **Vendimi Nr.454, datë 07.10.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional, të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, znj. Donald Kalem”.**
- ✚ **Vendimi Nr.455, datë 07.10.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional, të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, znj. Alma Anxhara”.**
- ✚ **Vendimi Nr.456, datë 07.10.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional, të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, znj. Greta Basha”.**
- ✚ **Vendimi Nr.465, datë 13.10.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelares në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, znj. Viola Kondo”.**
- ✚ **Vendimi Nr.466, datë 13.10.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelares në detyrë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, znj. Dhurata Abazi”.**
- ✚ **Vendim Nr.467, datë 13.10.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje, z. Eugen Sylari”.**
- ✚ **Vendim Nr.468, datë 13.10.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelares në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, znj. Shpresa Cenaj”.**

- ✚ **Vendimi Nr.469, datë 13.10.2021, “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, z. Luan Gega”.**
- ✚ **Vendimi Nr.470, datë 13.10.2021, “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, z. Arbër Kushe, për shkak të dorëheqjes”.**
- ✚ **Vendimi Nr.484, datë 19.10.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelares në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Lertida Balili”.**
- ✚ **Vendimi Nr.539, datë 17.11.2021, “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë z. Shkëlzen Mulosmani”.**
- ✚ **Vendimi Nr.561, datë 01.12.2021, “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të znj. Blerta Nurja, kancelare në detyrë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për shkak të dorëheqjes”.**
- ✚ **Vendimi Nr.594, datë 23.12.2021, “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, të pasurisë dhe figurës, për kancelarin në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, z. Arbër Kushe”.**

Vendimmarrje që kanë lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit të tyre në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit dhe në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, të tilla si vendimet që vijojnë:

- ✚ **Vendimi Nr.369, datë 14.09.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. Eranda Hysi”.**
- ✚ **Vendimi Nr.370, datë 14.09.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. Orjela Skënderi”.**
- ✚ **Vendimi Nr.371, datë 14.09.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. Blerta Aliu”.**
- ✚ **Vendimi Nr.372, datë 14.09.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. Evriklejda Semani”.**
- ✚ **Vendimi Nr.373, datë 14.09.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të z. Metush Meçka”.**
- ✚ **Vendimi Nr.374, datë 14.09.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. Enkelejda Patrioti”.**

- ✚ Vendimi Nr.375, datë 14.09.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. Nertila Kalanxhi”.
- ✚ Vendimi Nr.376, datë 14.09.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. Blerta Hamzallari”.
- ✚ Vendimi Nr.377, datë 14.09.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. Irena Zhurka”.
- ✚ Vendimi Nr.378, datë 14.09.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të z. Sokol Loci”.
- ✚ Vendimi Nr.379, datë 14.09.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. Gersiana Skifteri”.
- ✚ Vendimi Nr.407, datë 29.09.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. Elenita Myftari”.
- ✚ Vendimi Nr.408, datë 29.09.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të z. Zef Macaj”.
- ✚ Vendimi Nr.436, datë 04.10.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. Stela Qako”.
- ✚ Vendimi Nr.481, datë 19.10.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. Inesa Çela (Elezi)”.
- ✚ Vendimi Nr.482, datë 19.10.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. Eglantina Shabanaj”.
- ✚ Vendimi Nr.483, datë 19.10.2021, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. Edlira Llango”.

Ndërkaq, në funksion të rritjes së efijencës së sistemit gjyqësor, **me fokus të veçantë Gjykatën e Lartë** për shkak të situatës problematike që kjo e fundit paraqet lidhur me stokun e çështjeve të prapambetura, Komisioni si struktura përgjegjëse për garantimin e mirëqeverisjes së sistemit, ka miratuar një sërë vendimmarrjesh që lidhen me emërimin në pozicionin e këshilltarit ligjor apo pranimin e kandidatëve në shërbimin gjyqësor civil në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së lartë si më poshtë:

- ✚ Vendimi nr.486 datë 19.10.2021 “Për Pranimin në Shërbimin Civil Gjyqësor të znj. Eranda Hysi, në pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Lartë”.
- ✚ Vendimi nr.487 datë 19.10.2021 “Për Pranimin në Shërbimin Civil Gjyqësor të z. Zef Macaj, në pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Lartë”.

- ✚ **Vendimi nr.488 datë 19.10.2021 “Për Pranimin në Shërbimin Civil Gjyqësor të znj. Elenita Myftari, në pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Lartë”.**
- ✚ **Vendimi nr.497 datë 25.10.2021 “Për Pranimin në Shërbimin Civil Gjyqësor të znj. Inesa Çela (Elezi), për Pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Lartë”.**
- ✚ **Vendimi nr.498 datë 25.10.2021 “Për Pranimin në Shërbimin Civil Gjyqësor të znj. Edlira Lango, për Pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Lartë”.**
- ✚ **Vendimi nr.499 datë 25.10.2021 “Për Pranimin në Shërbimin Civil Gjyqësor të z. Metush Meçka, për Pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Lartë”.**
- ✚ **Vendimi nr.500 datë 25.10.2021 “Për Pranimin në Shërbimin Civil Gjyqësor të znj. Evriklejda Semani, për Pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Lartë”.**

Këto vendimmarrje reflektojnë qasjen e Komisionit lidhur me rolin dhe rëndësinë që ka personeli mbështetës, krahas gjyqtarëve, në ritmet e evadimit të dosjeve dhe për pasojë edhe në reduktimin e vonesave në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore për publikun.

Përpos sa më sipër, përmendim gjithashtu edhe një sërë vendimmarrjesh që kanë lidhje me procedurën e verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për gjyqtarë, këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, viti akademik 2021-2022, të tilla si vendimet që vijojnë:

- ✚ **Vendimi Nr.38, datë 04.02.2021, “Për ngritjen dhe përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, për vitin akademik 2021-2022”.** Ky Vendim parashikon ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, për vitin akademik 2021-2022. Sipas këtij vendimi Komisioni i Përkohshëm përbëhet nga tre anëtarë, 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jo gjyqtar, të cilët zgjidhen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me short. Kryetari i Komisionit zgjidhet nga anëtarët e tij me propozim të Kryetarit të Këshillit. Komisioni i Përkohshëm merr masat për përbushjen e detyrës së tij bazuar në procedurat dhe afatet e parashikuara në vendimin nr.424, datë 12.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”.
- ✚ **Vendimi Nr.217, datë 26.05.2021, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për këshilltar dhe ndihmës ligjorë, viti akademik 2021-**

2022 i ndryshuar me vendimin nr.501, datë 25.10.2021⁷”. Përmes këtij Vendimi, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022, duke caktuar dhe relatorin për secilin kandidat, nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të KPSAB-së. Referuar listës përfundimtare të kandidatëve fitues për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2021-2022, rezultoi të jenë 35 kandidatë, pra në përputhje me numrin e përcaktuar nga Këshilli me Vendimin nr.35, datë 28.01.2021.

- ✚ **Vendimi Nr.299, datë 13.07.2021, “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës të kandidatit për këshilltar ligjor z. Gerti Shani”.**
- ✚ **Vendimi Nr.300, datë 13.07.2021, “Për deklarimin e përfunduar pa vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës për z. Renato Tosku”.**
- ✚ **Vendimi Nr.301, datë 13.07.2021, “Për deklarimin e përfunduar pa vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës për z. Suzan Bushi”.**
- ✚ **Vendimi Nr.544, datë 23.11.2021, “Për kualifikimin e kandidatës fituese për në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021-2022, profile ndihmës ligjor, znj. Klaida Muçaj”.**
- ✚ **Vendimi Nr.548, datë 23.11.2021, “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për znj. Malvina Malaj”.**
- ✚ **Vendimi Nr.568, datë 07.12.2021, “Për kualifikimin e kandidatit fitues për këshilltar ligjor, në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2021-2022, z. Leonard Kryeziu”.**

Vendimmarrje të tjera të Komisionit lidhur me administrimin e sistemit gjyqësor janë⁸:

- ✚ **Vendimi Nr.14, datë 21.01.2021, “Për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari, për vitin 2021”.** Sipas këtij vendimi përcaktohet se Komisioni i Përkohshëm ka në përbërje, tre anëtarë, nga të cilët dy anëtarë jo gjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar, si dhe dy anëtarë zëvendësues konkretisht, një anëtar gjyqtar zëvendësues dhe një anëtar jo gjyqtar zëvendësues. Përbërja e Komisionit, sipas vendimit, do të bëhet në mbledhjen plenare të Këshillit, me

⁷ Vendimi nr.501, datë 25.10.2021 “Për një shtesë në vendimin nr.217, datë 26.05.2021 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për këshilltar dhe ndihmës ligjorë, viti akademik 2021-2022”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁸ Janë 64 vendimmarrje ku përfshihet dhe Vendimi Nr.174, datë 26.04.2021, “Për refuzimin e kërkesës së kandidatës znj. Alma Hicka, për përjashtimin e relatorit dhe të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nga procedurat nga të cilat ajo ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë”.

short, sipas rregullave të përcaktuara për organizimin e tij në pikën 6 të vendimit nr. 170, datë 28.05.2020 të KLGJ-së, “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”.

Me ndryshimet ligjore të miratuara në Kuvendin e RSh në paketën e refomës për drejtësi lindi nevoja për reflektimin e këtyre ndryshimeve dhe në aktet e KLGJ-së si më poshtë vijon:

✚ **Vendimi Nr.323, datë 22.07.2021, “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.338, datë 24.09.2020 “Për caktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”.** Sipas Vendimit, për sekretarët gjyqësorë në detyrë, që kanë mbi 3 vjet përvojë pune në këtë pozicion dhe janë me arsim të lartë, kriteri i diplomimit në drejtësi nuk përbën shkak për të mos njohur statusin e nëpunësit gjyqësor civil, nëse Këshilli i Gjykatës vlerëson pozitivisht performancën e tij në punë.

✚ **Vendimi Nr.324, datë 22.07.2021, “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.7, datë 21.12.2018 “Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave”.** Në rregulloren për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave bëhen disa shtesa dhe ndryshime. Më konkretisht, referuar ndryshimeve, mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të gjykatës zgjedh zëvendëskryetarin, ndërmjet gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën në atë gjykatë, për një mandat tre vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme. Gjithashtu, referuar ndryshimeve, vendimi përcakton se në rastet kur nuk konkurrojnë kandidatë që plotësojnë kriterin e përvojës minimale profesionale, ose kur asnjë nga gjyqtarët e gjykatës nuk e ka këtë përvojë, zëvendëskryetari i gjykatës zgjidhet ndërmjet gjyqtarëve të tjerë, që ushtrojnë funksionin në atë gjykatë, për një mandat njëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Vendimi parashikon gjithashtu, se përjashtimisht, deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas ligjit, kandidati për zëvendëskryetar të gjykatës së shkallës së parë duhet të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar, ndërsa kandidati për zëvendëskryetar të gjykatës së apelit duhet të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar i gjykatës së apelit.

✚ **Vendimi Nr.325, datë 22.07.2021, “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.643, datë 23.12.2020 “Për miratimin e rregullave standard për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”.** Vendimi reflekton ndryshimet ligjore të kryera nga legjislatori në Ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” të cilat hynë në fuqi në korrik të vitit 2021. Ai ka për qëllim përditësimin e rregullave dhe kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë duke ndryshuar kriteret e veçanta për rekrutim në pozicionin këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Reduktimi i përvojës së nevojshme të punës nga 10 në 5 vjet dhe heqja e kriterit mbi publikimin e botimeve akademike dhe artikujve shkencorë janë disa nga ndryshimet kryesore të pasqyruara në këtë vendim.

Në funksion të mirë-funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe buxhetor, KPSAB ka ndërmarrë vendimmarrjet e mëposhtme:

✚ **Vendimi nr. 172, datë 22.04.2021 “Për miratimin e kërkesave buxhetore, PBA 2022-2024 (Faza e Parë strategjike) të sistemit gjyqësor”.** Në funksion të administrimit dhe menaxhimit me përgjegjësi të buxhetit gjyqësor, KPSAB-ja ka shqyrtuar paraprakisht kërkesat buxhetore dhe projekt-buxhetin afatmesëm 2022-2024. Në hartimin e këtij akti, të propozuar në Këshill, KPSAB-ja ka argumentuar se kërkesat buxhetore, janë përgatitur duke pasur parasysh nevojat buxhetore në përputhje me vizionin, misionin, qëllimin, synimet dhe objektivat strategjike të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Më konkretisht, kërkesat buxhetore janë përgatitur për të tre programet buxhetore ku përfshihen programet e “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimit”, “Buxheti Gjyqësor” dhe “Mbështetja për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”.

✚ **Vendimi nr. 276, datë 01.07.2021 “Mbi pakësimin e fondeve në shpenzime personeli, në programin buxhetor “Buxheti Gjyqësor” për vitin 2021”.** Propozimi i këtij vendimi ka ardhur nga KPSAB-ja, për shkak të Aktit Normativ nr.26, datë 22.06.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2021”. Pakësimet janë kryer në “Shpenzime Korente”, në shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore) në programin buxhetor “Buxheti Gjyqësor” për 80,000,000 milion lekë.

✚ **Vendimi nr.294, datë 06.07.2021 “Mbi rishpërndarjen e fondeve për shpenzime korente dhe shpenzime kapitale (investime), në programin buxhetor “Buxheti Gjyqësor”.** Propozimi nga KPSAB-ja për rishpërndarjen e fondeve erdhi për shkak të ndryshimeve të ngjarjeve ekonomike të ndodhura të cilat kanë efekt si në shpenzime personeli ashtu edhe në investime. Kështu është kërkuar shtesë fondesh në shpenzime personeli nga gjykatat, si vijon: Gjykata e Apelit Vlorë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Kërkesa për rishpërndarje erdhi kryesisht për shkak të plotësimit të disa vendeve vakante në gjykata. Plotësimi i nevojave u propozua të realizohet nga fondi i paspërndarë në detajimin fillestar të fondeve në programin “Buxheti Gjyqësor”, artikulli 600 dhe 601.

✚ **Vendimi nr.326, datë 22.07.2021, “Për transferimin e fondeve, nga shpenzime personeli, në shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera, në programin buxhetor “Buxheti Gjyqësor”, për vitin 2021.** Në zbatim të kontratës së ruajtjes dhe sigurisë së gjykatave, KPSAB, propozoi transferimin e fondit prej 28,000,000 lekë nga Shpenzime Personeli (600 + 601) të lira në Gjykatën e Lartë, në Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera (602), në programin buxhetor “Buxheti Gjyqësor”. Gjithashtu u realizua rishpërndarja e fondeve në shpenzime operative. Kjo rishpërndarje u propozua për plotësimin kryesisht të kërkesave për ekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, por edhe kërkesa të reja të vlerësuara si të nevojshme nga gjykatat. Rishpërndarja e fondeve në këtë zë të shpenzimeve, u krye nëpërmjet pakësimit të fondeve në ato gjykata që nga analiza 6/mujore e fondeve, rezultonin me fonde të lira, duke marrë dhe konfirmimin e tyre. Rishpërndarja e fondeve në shpenzime kapitale u realizua, duke analizuar realizimin e fondeve për 6/mujorin e parë. Disa gjykata si Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, konfirmuan se kishin fonde të lira, pasi në kushtet e mungesës së numrit të punonjësve, rivlerësonin se nuk duhej të shtonin pajisjet e tyre elektronike, pavarësisht programimit. Në kushtet e fondeve të lira, por edhe të nevojave të evidentuara, u rikonceptua shpërndarja e fondeve në investime sipas nevojave të evidentuara. Kështu nëpërmjet rishpërndarjes fondet shkuan për

Gjykatën e Posaçme të Apelit KKO për rikonstrukcionin e sistemit të ngrohjes, në Gjykatën e Lartë, për përmirësimin e situatës së transportit të gjyqtarëve, pas plotësimit me anëtarët e rinj të gjykatës së Lartë, si dhe për realizimin e software-it “Formulari Elektronik i Aplikimit”, të propozuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Standardeve të Gjykatave në bashkëpunim me Drejtorinë e IT dhe Menaxhimit të Çështjeve. Nëpërmjet kësaj rishpërndarje të fondeve synohet plotësimi i nevojave dhe përdorimi eficient i buxhetit të sistemit gjyqësor.

✚ **Vendimi nr. 343, datë 26.08.2021, “Mbi miratimin e kërkesave për fonde buxhetore (PBA 2022-2024), për sistemin gjyqësor, (Faza e dytë).** Në funksion të administrimit dhe menaxhimit me përgjegjësi të buxhetit gjyqësor, KPSAB-ja ka shqyrtuar paraprakisht kërkesat buxhetore dhe projekt-buxhetin afatmesëm 2022-2024. Në hartimin e këtij akti, të propozuar në Këshill, KPSAB-ja ka konfirmuar kërkesat buxhetore të Fazës së Parë dhe ka argumentuar rritjen e nevojës për investime në përputhje me kërkesat strategjike për zhvillim.

✚ **Vendimi nr. 485, datë 19.10.2021, Mbi rishpërndarjen e fondeve në shpenzime personeli dhe shpenzime operative në programin buxhetor “Buxheti Gjyqësor”.** KPSAB i propozoi Këshillit rishpërndarjen e fondeve për plotësimin e nevojave të paraqitura për pagesën e diferencës prej 25% të pagës pas rikthimit në detyrë të një gjyqtari, nga përfundimi i procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe disa kërkesa të tjera të lindura. Plotësimi i nevojave u krye nga fondi i mbajtur i pashpërndarë në programin buxhetor “Buxheti Gjyqësor”.

✚ **Vendimi Nr. 502, datë 25.10.2021, “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve, në gjykata”.** Bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të Ministrisë së Financave, 12 (dymbëdhjetë) gjykata kanë zhvilluar dhe paraqitur për miratim procedurat për nxjerrje nga përdorimi të disa aktiveve që ato kanë në përdorim. Në këto kushte, është vendosur miratimi i nxjerrjes nga përdorimi të disa aktiveve në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit Gjirokastër, Gjykatën e Apelit Tiranë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

✚ **Vendimi nr. 503, datë 25.10.2021, “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve në gjykata”.** Me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli vendosi transferimin e 2 (dy) automjeteve të reja, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në Gjykatën e Lartë, si dhe transferimin e 2 (dy) automjeteve në përdorim të Gjykatës së Lartë, përkatësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

✚ **Vendimi nr. 529, datë 10.11.2021, “Për rishpërndarjen e fondeve në shpenzime personeli në programin buxhetor “Buxheti Gjyqësor”.** KPSAB i propozoi Këshillit rishpërndarjen e fondeve, me objektiv zbatimin e Vendimit gjyqësor nr. 410, datë 14.7.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit, për pagesën e ndihmësve ligjorë në Gjykatën Administrative të Apelit. Pavarësisht rekursit të kërkuar në Gjykatën e Lartë, u

gjkua zbatimi i këtij vendimi pasi është një vendim i formës së prerë. Moszbatimi i tij do të krijonte kosto penalteti.


- ✚ **Vendimi nr. 549, datë 23.11.2021, “Për transferimin e motoçikletave në gjykatat e rrethit gjyqësor Tiranë dhe Durrës”.** Në zbatim të programimit për përmirësimin e situatës së njoftimit të palëve në proceset gjyqësore nëpërmjet ftuesve në gjykata, u prokurua blerja e motoçikletave. Nga KPSAB u propozua shpërndarja e motoçikletave në gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë e Durrës, sikurse ishin programuar në detajimin e fondeve buxhetore.
- ✚ **Vendimi nr. 596, datë 23.12.2021, “Për detajimin e fondeve buxhetore, në sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2022”.** Me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë Gjyqësor përmes këtij vendimi ka miratuar detajimin e fondeve buxhetore (shpenzime personeli, shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale) në programin buxhetor të vitit 2022 lidhur me planifikimin, menaxhimin dhe administrimin. Gjithashtu, ky vendim ka përcaktuar edhe detajimin e fondeve buxhetore (shpenzime personeli dhe shpenzime korrente) në programin buxhetor lidhur me mbështetjen për teknologjinë e sistemit të drejtësisë, si dhe detajimin e fondeve buxhetore, në shpenzime korrente (shpenzime për paga, shpenzime për sigurime shoqërore dhe shpenzime operative) dhe kapitale (investime), në programin buxhetor sa i përket buxhetit gjyqësor. Ndërkaq, KLGJ-ja përmes këtij vendimi ka miratuar edhe detajimin e të ardhurave të gjykatave për vitin 2022.

Gjithashtu, ligji i ka ngarkuar Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit një rol të rëndësishëm lidhur me administrimin e sistemit gjyqësor nga pikëpamja e burimeve njerëzore. Kjo kompetencë shtrihet edhe për administrimin dhe adresimin e problematikave që burojnë nga procesi i rivlerësimit kalimtar si dhe për garantimin e standardeve apo përcaktimin e kriterëve lidhur me statusin e nëpunësit civil ose punonjësit gjyqësor. Në kuadër të kësaj kompetence ligjore, Komisioni ka ndërmarrë aktin e mëposhtëm:

- ✚ **Vendimi Nr.84, datë 11.03.2021, “Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2021”.** Ky vendim ka detajuar numrin e punonjësve të njëjësve shpenzuese në varësi të saj, të përcaktuar në ligjin vjetor të buxhetit të vitin 2021. Më konkretisht, me numrin e punonjësve të miratuar për vitin 2020, raporti i stafit të gjyqtarëve me stafin administrativ ishte 1:2.59 (1 gjyqtar: 2.59 staf mbështetës), ndërsa me numrin e miratuar për vitin 2021, raporti do të jetë 1 gjyqtar:2.79. Analiza për shpërndarjen e numrave të miratuar për 2021, synon aplikimin e standardeve që parashikon Ligji 98/2016, duke u përpjekur që të për afrohen dhe përmbushen standardet evropiane në lidhje me numrin e stafit jo gjyqtar që duhet të kenë gjykatat në raport me gjyqtarët. E megjithatë, ndonëse me rezerva është shtuar numri i punonjësve për disa pozicione, përsëri ka mungesa të stafit administrativ apo të mbingarkesës për disa pozicione. Për këtë qëllim, në të ardhmen parashikohet që një nga masat për adresimin e problemit të përcaktimi të ngarkesës së gjyqtarëve, i numrit të gjyqtarëve në raport me çështjet gjyqësore dhe për rrjedhojë i stafit administrativ në raport me stafin e gjyqtarëve të jetë dhe miratimi dhe zbatimi i Hartës së re gjyqësore.

6. PËRMIRËSIMET NË INFRASTRUKTURËN TEKNOLOGJIKE NË FUNKSION TË RRRITJES SË TRANSPARENCËS, EFICENCËS DHE AKSESIT NË SISTEMIN GJYQËSOR

Pas zhvillimit dhe zbatimit të 84 ndryshimeve strategjike në sistemet e menaxhimit të çështjeve në gjykata (case-management informatic system) të kryera një vit më parë, gjatë vitit 2021 ka vazhduar monitorimi i zbatimit të tyre në praktikë dhe është dhënë mbështetja e nevojshme nëpërmjet sistemit të ngritur “ticketing desk”. Në këtë aspekt është ofruar mbështetje teknike për të gjithë gjykatat lidhur me 667 kërkesa për suport të administruara.



Disa nga ndryshimet më të rëndësishme të kryera gjatë këtij viti raportues janë:

Ndryshimi ndërfaqes grafike të sistemit ICMIS

Pas 15 vjet përdorimi, faqja e hyrjes në sistemin e menaxhimit të çështjeve (ICMIS) u rikonceptua duke sjellë ndryshime si në aspektin vizual ashtu edhe lehtësim në përdorimin e filtrave në sistemin e menaxhimit duke e bërë atë më të thjeshtë për tu përdorur.

Shtimi i avokatëve dhe ekspertëve dhe marrja me short e avokatëve kryesisht

Në zhvillimet e reja të sistemit ICMIS është përfshirë edhe plotësimi i të dhënave në lidhje me avokatët, si dhe ekspertët e caktuar nga gjykata. Sa i përket avokatëve të zgjedhur, ata regjistrohen në sistem për çdo palë sipas aktit të përfaqësimit apo pas deklaramit në seancën gjyqësore. Ndërsa për avokatët e caktuar kryesisht nga gjykata, është shtuar në ndërfaqe mundësia e zgjedhjes së tyre në mënyrë rastësore. Ky funksionalitet i ngjashëm me caktimin me short të gjyqtarit bën të mundur caktimin në mënyrë rastësore edhe të avokatit kryesisht.

Përdorimi i të dhënave gjyqësore të anonimizuara

Gjatë vitit 2021, janë shtuar funksionalitete të reja në kuadrin e anonimizimit automatik të të dhënave të vendimeve gjyqësore, të kryera 1 vit më parë. Këto funksionalitete i shërbejnë rritjes së transparencës, aksesit në gjykata, llogaridhënies së sistemit gjyqësor si dhe mbi parimin e ekuilibrit të drejtë midis të drejtës së individëve për informacion dhe mbrojtje të të dhënave personale. Gjithashtu për t'i siguruar publikut të drejtën për tu njohur me praktikën gjyqësore, për qëllime studimore, shkencore, statistikore, literature apo gazetarie, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, praktikat gjyqësore të anonimizuara tashmë mund të aksesohen duke përdorur filtrat në portalin gjykata.gov.al sipas llojit të çështjes dhe mënyrës së përfundimit.

Për palët në proces, është krijuar mundësia e aksesit të informacionit të plotë për çështjen dhe vendimet gjyqësore të pa-anonimizuara, nëpërmjet mënyrës së identifikimit të sigurt. Të dhënat janë të sigurta nëpërmjet një ID-je universale unike, duke përdorur një numër pseudo të rastësishëm 128-bit. GUID-i përdoret për të identifikuar dhe aksesuar në mënyrën më të sigurtë të mundshme të dhënat gjyqësore.

Aksesi në kohë reale nga këshilltarët ligjorë të Gjykatës së Lartë i vendimeve të gjykatave më të ulëta

Nga ana e administratës së kësaj gjykate është ngritur shpesh problematika në lidhje me kohën e shpenzuar për hedhjen manualisht të vendimeve të gjykatave të niveleve më të ulëta. Tashmë kjo procedure është lehtësuar duke bërë të mundur aksesin e drejtpërdrejt në vendimet gjyqësore. Ky proces i cili pritet të ulë ndjeshëm kohën e procedimit të vendimeve duke shmangur njëkohësisht dhe gabimet njerëzore, vjen në kuadër të politikave për uljen e çështjeve të mbartura në Gjykatën e Lartë.

Janë shtuar në portalin gjykata.gov.al raportimet statistikore mbi çështjet e dhunës në familje.

Nisur si nga natyra sensitive e çështjeve të dhunës në familje dhe nevoja për të bashkërenduar punën dhe me strukturat e tjera në nivel qendror dhe lokal, në portalin gjykata.gov.al është krijuar seksioni i raportimeve statistikore për çështjet me objekt “Lëshim urdhër i mbrojtjes”(UM) dhe “Lëshim urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes” (UMM). Këto raporte përditësohen dhe pasqyrohen në kohë reale në portal, për të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore.

30 përmirësime të përshtatura për Gjykatën e Lartë në sistemin ICMIS.

Bazuar në kërkesat e Gjykatës së Lartë, gjatë vitit 2021 janë zhvilluar 30 ndërhyrje në sistemin e menaxhimit të saj të çështjeve. Ndërhyrjet kanë synuar lehtësimin e punës së administratës duke rritur automatizimin e një sërë proceseve. Ndër to mund të përmendim:

- ✚ Aksesimi i vendimeve gjyqësore në kohë reale, nga shkallët e tjera të gjyqësorit.
- ✚ Shtimi i opsionit të ndarjes së çështjeve këshilltarëve ligjorë nga Kryetari.
- ✚ Mundësimi i sinjalizimit elektronik në sistem, për Kryetarin e gjykatës, kryesekretarët, gjyqtarët, këshilltarët për çështjet të cilave u afrohen afatet ligjore etj.

Çështje të tjera të rëndësishme dhe të trajtuara nga KPSAB-ja në lidhje me teknologjinë e informacionit të përdorur si nga vetë institucioni i KLGJ-së dhe nga gjykatat në vend dhe me qëllim rritjen e efikasitetit apo cilësisë në ofrimin e shërbimeve për të gjithë aktorët përdorues të sistemit duke pasur në fokus automatizimin dhe ofrimin e tyre në mënyrë elektronike (online), mund të përmendim si vijon:

- ✚ **Miratimin e parametrave të unifikuara për dhomat e serverit nëpër gjykata nga Komisioni i Planifikimit strategjik administrimit dhe buxhetit, vendosi miratimin e një dokumenti lidhur me standardizimin e dhomës së serverit në gjykata.** Një ndër arritjet më të rëndësishme të realizuar nga drejtoria e IT, drejt sistemit të ri CMS ishte unifikimi i standardeve për dhomat e serverit nëpër gjykata. Për të minimizuar probabilitetin e mosfunksionimit të sistemeve të informacionit nga faktorë të jashtëm si dhe në kuadër të rritjes së sigurisë së informacionit, janë përpunuar rregulla dhe kushte teknike të përbashkëta për të gjitha gjykatat. Dokumenti i përgatitur ka si objekt standardizimin në ndërtim dhe garantimin e funksionimit të infrastrukturës kompjuterike në kushte normale si dhe në kushte emergjence. Standardet e propozuara janë në përputhje me kushtet teknike të cilat do të garantojnë një infrastrukturë të përshtatshme brenda parametrave të temperaturës, lagështisë, furnizimit me energji etj. Dokumenti përcakton kushtet e nevojshme për mirëfunksionimin e pajisjeve IT dhe shërbimit non-stop, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- ✚ **Vendim Nr. 291, datë 06.07.2021 “Për shpërndarjen e pajisjeve it, dhuratë nga projektit Euralius V, në gjykatat e të gjitha niveleve”.** Sipas këtij Vendimi, projekti EURALIUS V, i ka dhuruar Këshillit të Lartë Gjyqësor, disa pajisje të TI, me qëllim sigurimin e funksionimit efikas të gjykatave në Shqipëri dhe transformimin e qetë elektronik të seancave në sallat e gjykatave të të gjitha niveleve, në një situatë emergjente gjatë karantinës dhe masave të marra ndaj virusit SARS-COVID 19 për funksionimin ditor të nivelit të përdoruesit. Duke qenë se qëllimi i këtij dhurimi është sigurimi i funksionimit efikas të gjykatave dhe transformimin e qetë elektronik të seancave në sallat e gjykatave të të gjitha niveleve, në një situatë emergjente gjatë periudhës së pandemisë, atëherë këto pajisje u vendos t’i shpërndahen gjykatave të të gjitha niveleve.
- ✚ **Përpilimi i Projekt - Udhërrëfyesit për zhvillimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve.** Projekti për zhvillimin dhe zbatimin e Sistemit të ri CMS, është përmbledhur dhe artikulluar në një dokument teknik, “Projekt -Udhërrëfyesi për sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve.” Ky dokument përfaqëson hapin më domethënës për KLGJ në zbatimin e qëllimeve dhe sfidave të digjitalizimit. Dokumenti u paraqit përpara bordit

drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit i cili e miratoi pa ndryshime me vendimin nr. 6, datë 17.12.2021. Ajo që synohet është që sistemi i ri të jetë një sistem i menaxhimit të të dhënave dhe dokumenteve me bazë web-in për të gjitha gjykatat në Shqipëri. Sistemi ri synohet të funksionojë me një instalim të vetëm, të centralizuar, i cili do të thjeshtojë vendosjen e versioneve të reja të software-it dhe aktivitetet e mirëmbajtjes. Nëpërmjet centralizimit të bazës së të dhënave pritet të mundësohet aksesimi dhe transferimi sinkron i të dhënave, aktualisht të gjendura në dy databaza të ndryshme.

✚ **Miratimi dhe implementimi i “Formularit elektronik të aplikimit” (FEA).** Në pritje të krijimit të sistemit të ri CMIS tërësisht interaktiv, Drejtoria e IT ka përpunuar metoda alternative për zgjidhjen e problematikave në kohë sa më të shkurtër. Që prej datës 9.11.2021, në portalin e përbashkët të gjykatave, ofrohet aplikimi online për shërbimet administrative në gjykatë. Në mënyrë të thjeshtuar, çdo përdorues i gjykatave në vend, nëpërmjet një formulari aplikimi përcakton shërbimin e kërkuar dhe brenda 48 orëve paraqitet në gjykatë për tërheqjen e dokumentacionit të kërkuar. Ndërkohë është parashikuar mundësia e njoftimit nëpërmjet emailit ose telefonit për tërheqjen e dokumentacionit nga momenti i përgatitjes së tyre, përpara afatit 48 orësh. Nëpërmjet aplikacionit ofrohet shërbimi për tërheqje vendimesh gjyqësore, kopje dosjesh gjyqësore dhe tërheqje dokumentacioni nga arkiva e gjykatës. Gjithashtu mundësohet aplikimi paraprak për vërtetimet e gjendjes gjyqësore si dhe të gjitha vërtetimet e tjera që lëshon gjykata. Përfitimet strategjike dhe operacionale të zbatimit të Projektit FEA është ofrimi i shërbimeve elektronike për marrjen e dokumenteve gjyqësor nga gjykata pa pasur nevojë për tu paraqitur fizikisht pranë tyre. Në këtë mënyrë, shmangen radhët e gjata në gjykatë dhe përhapja e virusit SARS - CoV19, si edhe kursehet kohë jo vetëm nga ana e palës që kërkon shërbimin (qytetar, biznes, vizitor), por edhe nga ana e punonjësve të gjykatës, që duhet të japin informacion në lidhje me hapat e procedurave apo dokumentacionit që nevojitet për përfitim të një shërbimi.

✚ **Manuali për ndryshimet ligjore.** Ndodhur në kushtet e ndryshimeve thelbësore të menaxhimit të çështjes për shkak të ndryshimeve ligjore të miratuara, janë përpunuar nga ana e drejtorisë së IT procedura standarde, të unifikuara për të gjitha gjykatat me qëllim automatizimin e procedurave të reja të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, sipas ligjit në fuqi. Këto praktika kanë lejuar shfrytëzimin maksimal të sistemit në gjendjen e aktuale pa pasur nevojë për zhvillime të tjera në sistem. Për rrjedhojë është shmangur nevoja e prokurimit të shërbimeve informatike shtesë. Praktikant janë reflektuar në një manual përdorimi për të lehtësuar punën e administratës gjyqësore.

✚ **Manuali mbi publikimin e programit të transparencës sipas formatit të ri të Komisionerit për të drejtën e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.** Në kuadër të mbështetjes që ofrohet nga sektori i suportit dhe menaxhimit të çështjeve, si dhe në respektim të afateve të caktuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit mbi publikimin e programit të transparencës nga gjykatat, është përgatitur një manual teknik i cili orienton punonjësit e gjykatave mbi mënyrën e publikimit dhe përditësimit të formatit të ri të programit të transparencës në portalin e gjykatave www.gjykata.gov.al. Lidhur me këtë pikë, vlen të theksohet se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka publikuar në muajin dhjetor 2021, Indeks të Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë. Referuar këtij monitorimi, të kryer gjatë vitit 2021, rezulton se KLGJ ka përmbushur plotësisht kriterin e publikimit në

uebfaqen e saj të Programit të Transparencës së Rishikuar. Ky detyrim rezulton gjithashtu i përmbushur edhe nga të gjitha gjykatat. Ndërkaq, në tërësi, referuar konkluzioneve të raportit, KLGJ-ja është vlerësuar me 4 pikë nga 5 maksimale, duke u klasifikuar me semafor të bardhë, pra si institucion me transparencë proaktive të mesme.

✚ **Automatizimi i gjenerimit të të dhënave statistikore sipas vendimeve të KLGJ nr. 47, datë 11.02.2021, duke përshtatur sistemin me qëllim realizimin e të dhënave statistikore sa më të sakta dhe të shpejta.** Në këtë drejtim ana e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, janë zhvilluar praktikat më të mira për përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve duke mundësuar gjenerimin e të dhënave statistikore sipas formateve të reja, të miratuara nga KLGJ. Për këtë qëllim, pas realizimit të ndryshimeve në sistemin e menaxhimit të çështjeve, është realizuar një seri trajnimesh në gjykatat e vendit me synim aftësimin e nëpunësve përgjegjës për prodhimin e statistikave. Tashmë raportimi nga ana e gjykatave gjenerohet në mënyrë të automatizuar për vendimin nr. 47, date 11.02.2021 “Për miratimin e “Udhëzuesit për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efijencës së gjykatave” të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

✚ **Marrja në administrim të sistemeve të zhvilluara nga USAID.** Këshilli i Lartë Gjyqësor ka fituar pronësinë e sistemeve elektronike të zhvilluara nga USAID në kuadër të rritjes së efijencës në gjykata. Këto programe janë si vijon:

- Calendar Management System PAKS+ i cili është Kalendari i menaxhimit të përdorimit të sallave të gjykimit nëpër gjykata.
- HC-Data Collection – aplikacion i krijuar për t’u përdorur nga nëpunësit e
- Kioska - aplikacioni i cili mundëson afishimin e shortit elektronik në hollin e gjykatës si dhe kalendarin e seancave dhe informacionet mbi çështjet.
- Backup Chain - Aplikacioni i cili bën të mundur transferimin e regjistrimeve audio nga serverët e gjykatave tek serveri qendror pranë AKSHI-T
- Recording Digital Audio server – Kalimi i pronësisë së serverit qëndron ku ruhen regjistrimet audio të seancave gjyqësore.

7. PLANIFIKIMI FINANCIAR NË FUNKSIONIN TË ADMINISTRIMIT TË MIRË DHE EFIKAS TË VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT DHE GJYKATAVE

Gjatë vitit 2021, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, krahas detyrave dhe përgjegjësi në lidhje me buxhetin vjetor të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Sistemit Gjyqësor, ka ndjekur procedurat e përcaktuara për hartimin dhe zbatimin të tij sipas legjislacionit përkatës.

KPSAB-ja, shqyrton dhe i propozon për miratim në seancën plenare KLGJ-së projektbuxhetin vjetor dhe afatmesëm të propozuar nga Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, si për KLGJ-në dhe për çdo nivel të gjykatave, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjatë vitit 2021, Komisioni ka kryer edhe monitorimin, rishpërndarjen e fondeve të akorduara, bazuar në kërkesat e gjykatave për fonde shtesë.

Për vitin 2021, me ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2021, pjesë e të cilit është edhe buxheti për sistemin gjyqësor (Këshilli i Lartë Gjyqësor), i ndarë në tre programe;

Programi buxhetor 01110, “**Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Programi buxhetor 01140, “**Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë**”, ku përfshihen kërkesat buxhetore për funksionimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit (QTI)

Programi buxhetor 03310, “**Buxheti Gjyqësor**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Fondet buxhetore të sistemit gjyqësor, të rishikuara, së bashku me realizimin 12 mujor, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

*Pasqyra nr.1,
Buxheti i miratuar për Sistemin Gjyqësor për vitin 2021*

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar për vitin 2021	Ndryshime gjatë vitit 2021	Buxheti i rishikuar për vitin 2021	Realizimi për vitin 2021	Realizimi për vitin 2021
1.	Shpenzime paga	2,450,000	-288,000	2,162,000	2,008,234	92%
2.	Shpenzime sig. shoqërore	297,000	-20,000	277,000	241,180	87%
3.	Shpenzime operative	497,200	28,000	525,200	456,300	87%
4.	Investime	200,000	-17,000	183,000	170,772	93%
	Totali	3,444,200	-297,000	3,147,200	2,876,486	91%

Gjatë vitit buxhetor 2021, buxheti i sistemit gjyqësor për shkak të situatës është rishikuar 2 herë, duke u shkurtuar në vlerën totale prej **297,000 mijë lekë**, (nga të cilat në shpenzime paga në vlerën 260,000 mijë lekë, shpenzime sigurime shoqërore 20,000 mijë lekë dhe shpenzime kapitale në vlerën 17,000 lekë), si më poshtë vijon:

Pakësimi i buxhetit me Aktin Normativ nr.26, datë 22.06.2021, në vlerën **80,000 mijë lekë** në programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor”.

Pakësimi i buxhetit me Aktin Normativ nr.34, datë 03.12.2021, në vlerën **217,000 mijë lekë** në programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor”.

Buxheti i miratuar për vitin 2021, për sistemin gjyqësor, i ndarë sipas programeve paraqitet sipas pasqyrës së mëposhtme:

*Pasqyra nr.2
Buxheti i miratuar sipas programeve për vitin 2021*

000 lekë

Kodi	Emërtimi	Paga	Sig. shoqërore	Shpenzime operative	Shpenzime investime	Totali shpenzime buxhetore
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	188,000	27,000	60,200	22,000	297,200
01140	Qendra e IT	5,000	1,500	2,000	0	8,500
03310	Buxheti Gjyqësor	2,257,000	268,500	435,000	178,000	3,138,500
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	2,450,000	297,000	497,200	200,000	3,444,200

- I. Programi buxhetor 01110, “**Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**”, ku përfshihen fondet buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Fondet buxhetore të miratuara për programin “Planifikim, Menaxhimi dhe Administrim”, sipas emërtimeve të shpenzimeve, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

*Pasqyra nr.3
Buxheti i miratuar për programin 01110*

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar për vitin 2021	Ndryshime gjate vitit 2021	Buxheti i rishikuar për vitin 2021	Realizimi për 2021	Diferenca	Realizimi për vitin 2021 %
1	Shpenzime paga	188,000	0	188,000	156,762	31,238	83%
2.	Shpenzime sig. shoqërore	27,000	0	27,000	20,489	6,511	76%
3	Shpenzime operative	60,200	0	60,200	46,345	13,855	78%
4	Investime	22,000	0	22,000	20,009	1,991	91%
	Totali	297,200	0	297,200	243,605	53,595	82%

Fondet buxhetore në programin “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, janë realizuar në masën **82%**, ose në vlerë absolute në shumën **243,605 mijë lekë**.

1. Shpenzime personeli⁹

Buxheti i miratuar në shpenzime personeli është **215,000 mijë lekë**, i ndarë përkatësisht **188,000 mijë lekë** në paga dhe 27,000 mijë lekë në sigurime shoqërore. Ky fond është përlogaritur dhe miratuar për **125 punonjës**. Realizimi në shpenzime personeli është kryer në masën **82%**, për shkak të mos plotësimit 100% të strukturës organike.

2. Shpenzime operative

Lidhur me shpenzimet operative është miratuar një fond në vlerën **60,200 mijë lekë**. Në këtë fond u përfshinë nevojat në shpenzimet operative për aktivitetin e përditshëm të KLGJ-së, referuar kërkesave të përcaktuara në fazën e projektbuxhetit sipas zërave të shpenzimeve si dhe

⁹ 1. Ku përfshihen paga dhe sigurime shoqërore

realizimit të vitit 2020.

Realizimi i shpenzimeve operative është kryer në masën 78%. Në këtë zë të shpenzimeve janë realizuar shpenzimet për aktivitetin e përditshëm të institucionit të KLGJ-së dhe fondi i kursyer është ai i dedikuar udhëtimeve e dietave, kryesisht jashtë vendit, i cili për shkak të situatës së pandemisë COVID-19 nuk është përdorur plotësisht. Realizimi i shpenzimeve korrente tregon për një menaxhim të mirë dhe me efektivitet.

3. Shpenzime Kapitale

Buxheti i miratuar në shpenzime kapitale (investime) ishte vlerën **22,000 mijë lekë**. Në këtë fond ishin përfshirë kryesisht nevojat për pajisje teknologjike. Realizimi i shpenzimeve kapitale është kryer në **masën 91 %**.

- II.** Programi buxhetor 01140, “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”.

Fondet buxhetore të miratuara për programin buxhetor 01140 ishin në vlerën **8,500 mijë lekë**. Ky fond nuk është realizuar për vitin 2021 pasi Qendra e TI është deklaruar e ngritur vetëm në tetor të vitit 2021 me Vendimin nr.1 datë 19.10.2021, ndërkohë që drejtori i saj është emëruar në detyrë në dhjetor të po këtij viti. Ky realizim buxhetor nuk ka qenë përgjegjësi e Komisionit PSAB apo KLGJ-së pasi ai ka qenë i ndërvarur nga një proces kompleks caktimesh të përfaqësuesve të bordit të QTI nga 10 institucione të ndryshme shtetërore. QTI ka filluar zyrtarisht funksionimin e saj më 17 dhjetor 2021.

- III.** Programi buxhetor 03310, “Buxheti Gjyqësor”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të gjitha nivelet.

*Pasqyra nr.4
Buxheti i miratuar për programin 03310*

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar në fillim të vitit 2021	Ndryshimet gjatë vitit 2021	Buxheti rishikuar 2021	Realizimi për vitin 2021	Diferenca	Realizimi për vitin 2021 %
1	Shpenzime paga	2,257,000	-288,000	1,969,000	1,851,472	117,528	94%
2.	Shpenzime sigurime	268,500	-20,000	248,500	220,691	27,809	89%
3	Shpenzime operative	435,000	28,000	463,000	409,955	53,045	89%
4	Investime	178,000	-17,000	161,000	150,763	10,237	94%
	Totali	3,138,500	-297,000	2,841,500	2,632,881	208,619	93%

Fondet buxhetore në programin “Buxheti Gjyqësor”, janë realizuar në masën **93 %**.

1. Shpenzime personeli¹⁰

Buxheti i miratuar në këto shpenzime është **2,525,500 mijë lekë**, i ndarë në **2,257,000 mijë lekë** në paga dhe **268,500 mijë lekë** në sigurime shoqërore.

Buxheti në shpenzime personeli në këtë program është përlogaritur mbështetur në numrin e plotë të punonjësve sipas strukturave organike për të gjitha gjykatat dhe pagave dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për magjistratët edhe për administratën gjyqësore.

Realizimi në shpenzime personeli është kryer në masën 94 %. Numri faktik i punonjësve në gjykatat e të gjitha niveleve, në fund të vitit 2021, është **1,359** punonjës, kundrejt **1,548** punonjës sipas strukturës organizative. Konstatohet se gjatë vitit 2021 ka 189 punonjës më pak në sistem nga të cilët: 79 janë magjistratë, (mungesa e të cilëve vjen për shkak të shkarkimit, dorëheqjes ose mosplotësimin e vendeve të lira) dhe 110 të tjerë në administratën gjyqësore. Këto mungesa nuk ka qenë e mundur të plotësohen brenda vitit 2021.

2. Shpenzime operative

Buxheti i miratuar në shpenzime operative për vitin 2021 është **435,000 mijë lekë**, ndërkohë që **realizimi tyre është kryer në masën 89%**.

Pavarësisht vështirësive që solli vazhdimi i pandemisë globale COVID-19 dhe në vitin 2021, gjykatat kanë bërë përpjekje maksimale për të menaxhuar fondet buxhetore në mënyrë efektive dhe eficiente.

3. Shpenzime kapitale për programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”

Buxheti i miratuar për këtë program ishte **178,000 mijë lekë**. Këto fonde janë ndarë sipas projekteve të mëposhtme:

<i>000 lekë</i>						
Kodi i projektit	Emertimi i projektit	Fondet buxhetore 2021	Rishikim buxheti	Realizimi vjetor 2021	Diferenca	Realizimi %
18AD801	Blerje pajisje zyre	40,000	30,920	25,761	5,159	83%
18AD805	Blerje software	63,500	57,440	57,324	116	100%
M290072	Blerje pajisje elektronike	46,300	38,010	33,347	4,663	88%
M290075	Studime dhe Projektme	6,400	15,260	15,046	214	96%
M290068	Rikonstruksione	21,800	19,370	19,285	85	100%
	Totali	178,000	161,000	150,763	10,237	94%

Realizimi në shpenzime kapitale për programin 03310 është në masën 94%.

Për sa më sipër, sikurse vihet re edhe nga analiza raportuese e detajuar, **realizimi i buxhetit për vitin 2021, në sistemin gjyqësor, rezulton në masën 91 %**, nga të cilat:

¹⁰Ku përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore

- ✚ shpenzime paga, në masën 92 %,
- ✚ shpenzime sigurime shoqërore, në masën 87 %,
- ✚ shpenzime operative, në masën 87 %,
- ✚ shpenzime kapitale, në masën 93 %.

Si përfundim, dhe në përputhje dhe me realizimet e sipërpërmendura, KPSAB-ja ka dëshmuar një performancë të lartë duke reaguar më shpejtësi ndaj nevojave në sistemin gjyqësor dhe duke mundësuar një vendimmarrje të drejtë dhe ligjore të vetë Këshillit në funksion të menaxhimit të fondeve buxhetore me efikasitet dhe efektivitet.

8. VENDIMARRJE TË KPSAB DHE PROJEKTE

Komisioni i Planifikimit Strategjik Administrimit dhe Buxhetit, i mbështetur dhe nga partnerët ndërkombëtarë, është angazhuar duke analizuar situatën aktuale në sistemin gjyqësor shqiptar me synim evidentimin e masave apo mekanizmave me qëllim rritjen e efikasitetit të sistemit, lehtësimin e punës së gjyqtarëve, vrotimin e performancës dhe ofrimit të shërbimeve në gjykata dhe matjen e nivelit të kënaqësisë së përdoruesve të këtyre shërbimeve. Për këtë qëllim KPSAB-ja ka miratuar dhe po ndjek zhvillimin e projekteve të mëposhtme pilot;

✚ **Miratimi i “Plani i Veprimit”, “Pyetësor për Avokatët” dhe “Pyetësorë për Përdoruesit” për projektin e anketave të kënaqësisë së përdoruesve në gjykatë.** Në zbatim të nenit 94, pika 5 i Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar i cili parashikon zhvillimin e vrotimeve për vlerësimin e shërbimeve të gjykatave nga përdoruesit e tyre, KPSAB-ja në bashkëpunim me Këshillin e Evropës ka filluar punën për zhvillimin e këtyre vrotimeve. Në vijim të këtij angazhimi Komisioni ka miratuar tre dokumente teknike për zhvillimin e anketimeve dhe matjen e nivelit të kënaqësisë së përdoruesve të gjykatave dhe shërbimeve të ofruara prej tyre. Këto dokumente janë pyetësorë tip të përgatitur si për avokatët të cilët konsiderohen përdorues të rregullt të gjykatës dhe për përdoruesit qytetarë. Gjithashtu, Komisioni ka miratuar planin e veprimit, që parashikon hapat për zbatimin e projektit të sipër përmendur.

✚ **Monitorimi dhe lehtësimi i projektit pilot në lidhje me standardizimin e vendimeve për lëshimin e urdhre të ekzekutimit, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bashkëpunim me Euralius V dhe ndërmjetësimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor ka realizuar gjatë vitit 2021 projektin pilot për standardizimin e vendimeve gjyqësore me objekt “Lëshim urdhër ekzekutimi”. Projekti synon të zhvillojë një procedurë automatike duke ulur afatet kohore për shqyrtimin e këtyre kërkesave në gjykatë. Në përfundim të projektit synohet të evidentohen praktika për miratimin e Vendimeve tip për lëshimin e urdhrit ekzekutiv, procedurë e cila do të mund të realizohet në masën më të madhe, nga nëpunës civil gjyqësor nën mbikëqyrjen e gjyqtarit përkatës. Projekti synon uljen e kohës së nevojshme për administrimin e dosjes nga gjyqtari, dhe uljen e afateve kohore tërësore deri në arsyetimin e vendimit për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit

Krahas trupës gjyqësore, Komisioni i ka kushtuar vëmendje të veçantë edhe rritjes së kapaciteteve profesionale të administratës gjyqësore. Kështu me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve gjyqësore, me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar (Misionit EURALIUS dhe projekteve EWMI dhe INL), **është hartuar kurrikula për trajnimin e nëpunësit civil gjyqësor**. Kjo kurrikulë trajnimi, e cila mbështetet në ekspertizën dhe modelet më të mira ndërkombëtare të administrimit gjyqësor, përbëhet nga 8 module (1 - Moduli Hyrje në Administrimin e Gjykatës; 2 - Moduli për Etikën; 3 - Moduli Burimet Njerëzore; 4 - Moduli për Menaxhimin e Lëvizjes së Çështjeve; 5 - Moduli për Buxhetin dhe Financën; 6 - Moduli për Marrëdhëniet me Publikun; si dhe 7 - Moduli për Shkrimin dhe Arsyetimin Ligjor).

- 🌟 Në periudhën 29 qershor – 12 nëntor **janë zhvilluar trajnimet e para pilot** me fokus të veçantë në çështjet dhe parimet e përgjithshme të administrimit të gjykatave, në të cilat 26 nëpunës civil gjyqësor (dhe 10 financier) janë trajnuar. Ky program trajnimesh përfundoi në fund të vitit 2021 me shpërndarjen e certifikatave për 36 pjesëmarrësit e parë të tij. Është e pritshme që trajnimet të vazhdojnë dhe gjatë vitit 2022 dhe më tej.

9. REKOMANDIME

Në kuadrin e një procesi realist e vetëvlerësues të veprimtarisë së tij, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i vetëdijshëm për sfidat e institucionit të KLGJ-së në zbatimin e vizionit dhe misionit të tij për mbrojtjen e pavarësisë së sistemit gjyqësor por dhe të dhënies së një drejtësie cilësore dhe efikase ndaj publikut, angazhohet të vazhdojë punën e tij me përgjegjësi e përkushtim duke rekomanduar si më poshtë:

- 1. Vijimin e hartimit të kuadrit nënligjor të nevojshëm për të gjitha proceset dhe çështjet me fokus planifikimin strategjik, administrimin dhe buxhetin e sistemit gjyqësor si dhe ato që lidhen me veprimtarinë dhe mirë-funksionimin e gjykatave, Këshillit dhe vetë Komisionin.**
- 2. Forcimi i bashkëpunimit me donatorët dhe projektet e ndihmës së huaj lidhur me çështje të administrimit, efikasitetit dhe transparencës të sistemit gjyqësor.**
- 3. Vazhdimin e zbatimit të reformës për nëpunësin civil gjyqësor me qëllim krijimin e një administrate të qëndrueshme, profesioniste dhe me integritet, përmes avancimit të procesit të verifikimit të punonjësve në detyrë apo rekrutimit të punonjësve të rinj në përputhje me standardet e vendosura në kuadrin ligjor në fuqi.**
- 4. Vazhdimi i zbatimit të projektit pilot të iniciuar gjatë vitit 2021 mbi trajnimin e administratës civile gjyqësore nëpër gjykata.**
- 5. Përfundimin e verifikimit të kritereve ligjore, pasurisë dhe integritetit për kancelarët në detyrë apo nëpunësit e tjerë civil gjyqësor.**
- 6. Vijimi i punës për identifikimin dhe parashikimin e nevojave të gjykatave me burime njerëzore dhe financiare dhe hartimi i kërkesave buxhetore realiste si për vitin 2022 dhe për buxhetin afat-mesëm të sistemit gjyqësor sipas hartës së re gjyqësore.**
- 7. Menaxhim të fondeve buxhetore të alokuara me efikasitet dhe efektivitet për KLGJ dhe ndjekje e monitorim të tyre.**

- 8. Ndjekje të nevojave të sistemit gjyqësor si për mirëmbajtjen dhe sigurinë e sistemit aktual të menaxhimit të çështjeve dhe për zhvillimin e një sistemi të ri e bashkëkohor të teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë.**
- 9. Rritja e nivelit të transparencës në drejtim të publikimit të të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar pasues në uebfaqen e institucionit.**